



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“RIPARIM I PAJISJEVE ELEKTRONIKE”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

K-E6-IV-24

Tiranë, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesi.....	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparëshme.....	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMI	5
Kompetenca të përgjithshme.....	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
E6-05-IV-0186-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në riparime të pajisjeve elektronike.	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
E6-05-IV-0187-24 Instalimi i pajisjeve elektronike dhe lidhja e tyre në rrjen e komunikimit	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
E6-05-IV-0188-24 Diagnostikimi, riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektronike.....	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
E6-05-IV-0189-24 Dokumentacioni teknik dhe ligjor.....	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
E6-32-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere.....	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	11
E6-31-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale.....	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	13
E6-05-IV-0171-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	14
Kriteret e vlerësimit	14
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	15
Modalitetet e vlerësimit, Informacion shtesë.....	15
	2

SHËNIM	16
--------------	----

Emërtimi i kualifikimit	“Riparim i pajisjeve elektronike”			Kodi K-E6-IV-24
Kohëzgjatja	3000 orë nacionale	Niveli	IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Riparim i pajisjeve elektronike” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë teknik të mesëm për kryerjen e implementimit, mirëmbajtjes dhe operimin e pajisjeve elektronike, për krijimin e një biznesi privat, si dhe të zhvillojë personalitetin e individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Riparim i pajisjeve elektronike” të nivelit IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: – kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme të “Elektroteknikë”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, ; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Riparim i pajisjeve elektronike” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën profesionale dhe Suplementin përkatës të teknikut të mesëm në këtë fushë. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje që ofrojnë shërbime për pajisje dhe sisteme elektronike, në njësi të shitjes së pajisjeve elektronike, si dhe në veprimtari të tjera që ushtrohen në këtë drejtim. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e riparimeve të pajisjeve elektronike. Me përfundimin e kualifikimit profesional “Riparim i pajisjeve elektronike” niveli IV-të në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi ka mundësi për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Ofruesi	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2024			
Data e miratimit	(kur të miratohet)			
Variantet e mëparëshme	K-II-02-14 ; E6-IV-20			

STRUKTURA E KUALIFIKIMI

Në përfundim të kualifikimit profesional “Riparim i pajisjeve elektronike” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

Kompetenca të përgjithshme

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet.
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

E6-05-IV-0186-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në riparime të pajisjeve elektronike

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e marrjes së informacionit të saktë për realizimin e detyrës së caktuar;

2. Të interpretojë dokumentacionin teknik që shoqëron pajisjen sipas specifikimeve të prodhuesit;
3. Të shpjegojë rëndësinë e organizimit të punës dhe të vendit të punës për procese të ndryshme pune;
4. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të mjeteve, materialeve, dhe instrumenteve matëse dhe kontrolluese për riparimin e pajisjeve elektronike;
5. Të përshkruajë funksionin dhe përdorimin e instrumenteve matëse për riparimin e pajisjeve elektronike;
6. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të burimeve njerëzore dhe përzgjedhjen e tyre sipas proceseve të punës;
7. Të përshkruajë rëndësinë e planifikimit të kohës së punës sipas prioriteteve përkatëse;
8. Të interpretojë mënyrën e kontrollit të funksionalitetit të mjeteve dhe pajisjeve elektronike;
9. Të shpjegojë detyrat e ekipit të punës sipas kualifikimeve përkatëse;
10. Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me specialistë të tjerë për proceset e punës;
11. Të shpjegojë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
12. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të pastrimit, sistemit dhe mirëmbajtjes së vendit të punës sipas rregullores së brendshme;
13. Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të punës së kryer sipas rregullores së brendshme;
14. Të shpjegojë rëndësinë e inventarizimit të materialeve të konsumit pas proceseve të punës;
15. Të shpjegojë rëndësinë e raportimit për punën e kryer;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të menaxhojë burimet e nevojshme për planifikimin dhe organizimin e punës;
2. Të kryejë organizimin e punës sipas standardeve dhe udhëzimeve teknike;
3. Të dokumentojë dhe raportojë punën e kryer;

Kriteret e vlerësimit

- Harton planin për realizimin e punës sipas proceseve;
- Organizon punën dhe vendin e punës, sipas standardit;
- Përdor dokumentacionin teknik që shoqëron pajisjen, sipas nevojës;
- Planifikon mjetet, materialet dhe instrumentet matëse e kontrolluese për riparimin e pajisjeve elektronike sipas proceseve të punës;
- Përzgjedh mjetet, materialet, pajisjet elektronike dhe instrumentet matëse, sipas proceseve të punës;
- Planifikon burimet e nevojshme njerëzore sipas proceseve në punë dhe kualifikimeve përkatëse;
- Përzgjedh burimet njerëzore, sipas proceseve në punë dhe kualifikimeve përkatëse;
- Planifikon kohën e punës sipas prioriteteve përkatëse;
- Monitoron funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve elektronike, sipas manualeve;
- Përcakton detyrat e punës sipas rëndësisë së tyre;
- Realizon bashkëpunim të vazhdueshëm me specialistë të tjerë për proceset e punës, sipas rregullores së brendshme;
- Organizon vendin e punës në mënyrë ergonomike;

- Monitoron pastrimin, sistemimin dhe mirëmbajtjen e vendit të punës sipas rregullores së brendshme;
- Plotëson dhe ruan inventarin për materialet e konsumit sipas rregullores së brendshme;
- Plotëson dhe ruan dokumentacionin në vendin e punës sipas rregullores së brendshme;
- Raporton për punën e kryer sipas formateve të caktuara;

E6-05-IV-0187-24 Instalimi i pajisjeve elektronike dhe lidhja e tyre në rrjet

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë llojet e pajisjeve elektronike, karakteristikat dhe funksionin e tyre;
2. Të shpjegojë rëndësinë e interpretimit të skemave elektrike dhe elektronike të pajisjeve elektronike;
3. Të analizojë kushtet fizike të mjedisit ku do të funksionojë pajisja elektronike;
4. Të analizojë kushtet teknike të instalimit dhe të kabllimit;
5. Të shpjegojë karakteristikat, funksionet dhe përdorimet e kabllave;
6. Të përshkruajë teknikat e montimit sipas llojit të pajisjes elektronike dhe projektit;
7. Të shpjegojë mënyrat e instalimit dhe kabllimit sipas projektit dhe tipologjisë së pajisjes;
8. Të shpjegojë mënyrat e lidhjes së pajisjes elektronike me rrjetin;
9. Të shpjegojë mënyrat e testimeve fizike me instrumentet përkatëse;
10. Të shpjegojë mënyrat e kalibrimit dhe rëndësinë e tyre;
11. Të klasifikojë llojet e software-ve në varësi të tipologjisë së pajisjes;
12. Të përshkruajë elementet e rrjeteve të komunikimit dhe funksionin e tyre;
13. Të përshkruajë mënyrën e operimit të rrjetave të komunikimit dhe sistemeve të pajisjeve elektronike;
14. Të përshkruajë mënyrat e instalimit të sistemeve të operimit në varësi të tipologjisë së pajisjes elektronike;
15. Të përshkruajë mënyrat e konfigurimeve në pajisjet elektronike;
16. Të shpjegojë mënyrat e testimit të funksionimit të pajisjes;
17. Të shpjegojë rëndësinë e marrjes së informacionit për funksionimin e pajisjes pas lidhjes në rrjet.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë procedurat e instalimit të pajisjeve elektronike;
2. Të zbatojë teknikat e lidhjes së pajisjeve elektronike në rrjet;
3. Të kryejë matje dhe teste pas lidhjes në rrjet;

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon pajisjet elektronike për instalim sipas karakteristikave dhe funksionit të tyre;
- Interpretin skemat elektrike dhe elektronike të pajisjeve elektronike sipas nevojës;
- Përzgjedh komponentët elektronikë gjatë procesit të instalimit, sipas nevojës;
- Verifikon kushtet fizike të mjedisit ku do bëhet instalimi sipas manualit të përdorimit;
- Përcakton kushtet teknike të instalimit dhe të kabllimit sipas manualit standard të instalimit;
- Përcakton teknikat e montimit sipas llojit të pajisjes dhe projektit;
- Kryen kabllimin e pajisjes elektronike sipas manualit të përdorimit dhe procedurave

përkatëse.

- Monton pajisjen në rrjet sipas plan vendosjes dhe kërkesave të pajisjes elektronike;
- Kryen testime fizike dhe kalibrime sipas standardeve (standardeve të certifikuara);
- Instalon sistemet e operimit dhe software-t e pajisjeve elektronike në rrjet duke respektuar procedurën përkatëse të instalimit dhe rekomandimet e prodhuesit;
- Kryen konfigurime të pajisjes me rrjetin e komunikimit sipas manualit;
- Kryen testime të pajisjes së instaluar për funksionim e saj sipas manualit të përdorimit;
- Merr informacion nga klienti për funksionimin e pajisjes sipas kushteve të garancisë;

E6-05-IV-0188-24 Diagnostikimi, riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektronike

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë mënyrat e kontrollit në prezencë (vizual dhe akustik) të pajisjes elektronike për të verifikuar integritetin dhe funksionimin e saj përpara përdorimit të saj në ambientet e punës;
2. Të shpjegojë parimet e punës dhe ndërtimin e qarqeve elektronike dhe elementëve përbërës të tyre për të ndërtuar dhe riparuar qarqe elektronike;
3. Të përshkruajë llojet e defekteve dhe mënyrën e vlerësimit të pasojave për performancën dhe sigurinë e pajisjes.
4. Të përshkruajë llojet e sinjalistikave dhe kodet e problemit (error code) që shfaqen në pajisjet elektronike për të diagnostikuar dhe zgjidhur problemet e mundshme;
5. Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të informacionit për të siguruar që informacioni i nevojshëm është i disponueshëm dhe i përdorshëm në kohën dhe vendin e duhur;
6. Të shpjegojë rëndësinë e parandalimit të shkarkimeve elektrostatike që mund të dëmtojnë pajisjet elektronike dhe masat paraprake për të minimizuar pasojat negative të tyre.
7. Të shpjegojë mënyrat e çmontimit të pjesëve përbërëse të pajisjes dhe teknikat e zëvendësimit të komponentëve të dëmtuar;
8. Të shpjegojë llojet dhe teknikat e matjeve fizike, si dhe teknikat për të vlerësuar dhe monitoruar karakteristikat dhe performancën e pajisjeve dhe komponentëve elektronikë;
9. Të përshkruajë formatet dhe mënyrat e hartimit të preventivit teknik të shërbimeve në pajisje;
10. Të përshkruajë mënyrat e saldimit ose lidhjes duke përdorur mjete dhe materiale të nevojshme për të siguruar lidhjen e qëndrueshme;
11. Të argumentojë rëndësinë e përshtatjes së pjesëve të zëvendësuara me funksionalitetin e pajisjes elektronike;
12. Të shpjegojë teknikat e instalimit të modulit të riparuar për të rikthyer funksionimin e plotë të pajisjes;
13. Të shpjegojë mënyrat e pastrimit dhe përforcimit të kontakteve, duke përdorur mjetet dhe materialet e përshtatshme për të mbajtur lidhjet të qëndrueshme dhe të sigurta;
14. Të shpjegojë rëndësinë e riinstalimit ose rikonfigurimit të software-it për të siguruar funksionimin e duhur dhe për të minimizuar mundësitë e problemeve të mëtejshme;
15. Të argumentojë rëndësinë e testimit për të verifikuar funksionimin e saktë dhe të qëndrueshëm të pajisjes elektronike pas riparimit;
16. Të përshkruajë llojet e mirëmbajtjeve dhe përdorimet e tyre;
17. Të shpjegojë mënyrën e hartimit dhe rëndësinë e zbatimit të grafikut të mirëmbajtjes

- sipas afateve kohore dhe kushteve të përdorimit të pajisjes;
18. Të argumentojë rëndësinë e kontrollit të statusit të pajisjes për të identifikuar shenjat e mundshme të dëmtimit ose mungesave që mund të ndikojnë në performancën dhe sigurinë e saj;
 19. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të parametrave termik të pajisjes;
 20. Të listojë llojet e materialeve, mjeteve për lubrifikim dhe përdorimet e tyre;
 21. Të shpjegojë llojet e shërbimeve të pastrimit dhe teknikat përkatëse;
 22. Të shpjegojë procedurat e kalibrimit;
 23. Të argumentojë rëndësinë e zëvendësimit të elementëve në fund të ciklit të jetës për të siguruar që performanca dhe siguria e pajisjes mbeten të nivelin e dëshiruar;
 24. Të përshkruajë llojet e testeve të sigurisë elektrike;
 25. Të përshkruajë mënyrat e përditësimit të sistemit të operimit dhe software-ve specifik.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kontrollojë funksionimin e pajisjes elektronike;
2. Të zbatojë procedurat e nevojshme të diagnostikimit për identifikimin e defektit;
3. Të kryejë mirëmbajtje periodike dhe të emergjencës sipas procedurave të caktuara dhe grafikut;
4. Të riparojë pajisjen elektronike duke zbatuar procedurën;

Kriteret e vlerësimit

- Kontrollon në prezencë (vizual dhe akustik) pajisjen elektronike për të verifikuar funksionimin e saj përpara përdorimit;
- Interpretin ndërtimin e qarqeve elektronike dhe elementëve përbërës të tyre sipas nevojës;
- Përcakton saktë defektet e identifikuar në pajisjet elektronike, sipas procedurës;
- Identifikon llojet e sinjalistikave dhe kodet e problemit (error code) që shfaqen në pajisjet elektronike për të diagnostikuar dhe zgjidhur problemet e mundshme;
- Vlerëson saktë informacionin për të siguruar që është i disponueshëm dhe i përdorshëm në kohën dhe vendin e duhur;
- Parandalon shkarkimet elektrostatische që mund të dëmtojnë pajisjet elektronike sipas standardit;
- Merr masa paraprake për të minimizuar pasojat negative të shkarkimeve elektrostatische sipas standardit.
- Çmonton pjesët përbërëse të pajisjes elektronike sipas teknikave të zëvendësimit të komponentëve të dëmtuar;
- Kryen matje fizike për të vlerësuar dhe monitoruar karakteristikat dhe performancën e pajisjeve dhe komponentëve elektronikë sipas procedurës;
- Harton preventivin teknik të shërbimeve në pajisje sipas formateve;
- Saldon dhe/ose lidh duke përdorur mjete dhe materiale të nevojshme për të siguruar lidhjen e qëndrueshme, sipas standardit;
- Përshtat pjesët e zëvendësuara me funksionalitetin e pajisjes elektronike, sipas manualit;
- Instalon modulën e riparuar për të rikthyer funksionimin e plotë të pajisjes elektronike, sipas procedurës;
- Pastron dhe përforcon kontaktet, duke përdorur mjetet dhe materialet e përshtatshme për

- të mbajtur lidhjet të qëndrueshme dhe të sigurta, sipas standardit;
- Riinstalon ose rikonfiguron softwaret, për të siguruar funksionimin e duhur dhe për të minimizuar mundësitë e problemeve të mëtejshme, sipas procedurës;
- Teston funksionimin e saktë dhe të qëndrueshëm të pajisjes pas riparimit;
- Kryen mirëmbajtje periodike në përputhje me kërkesat e standardeve teknike;
- Harton dhe zbaton grafikun e mirëmbajtjes sipas afateve kohore dhe kushteve të përdorimit të pajisjes elektronike;
- Kontrollon statusin e pajisjes elektronike për të identifikuar shenjat e mundshme të dëmtimit ose mungesave që mund të ndikojnë në performancën dhe sigurinë e saj sipas procedurës;
- Kontrollon parametrat termik të pajisjes elektronike duke i krahasuar me vlerat nominale;
- Përdor materialet, mjetet për lubrifikim sipas nevojës;
- Zbaton procedurat e kalibrimit;
- Zëvendëson elementët në fund të ciklit të jetës sipas manualit të pajisjes elektronike;
- Kryen teste të sigurisë elektrike sipas standardit;
- Përditëson sistemin e operimit dhe software-ve specifik sipas standardit.

E6-05-IV-0189-24 Dokumentacioni teknik dhe ligjor

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësi e zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe standardeve përkatëse të fushës;
2. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të dokumentacionit teknik;
3. Të përshkruajë rëndësinë e plotësimit të procesverbalit të instalimit dhe të konfigurimit;
4. Të shpjegojë rëndësinë e plotësimit të raporteve të shërbimeve sipas grafikut të mirëmbajtjes;
5. Të përshkruajë mënyrat e hartimit të kushteve të garancisë dhe rëndësia e komunikimit të tyre;
6. Të përshkruajë rëndësinë e përpilimit të aktit të dorëzimit të pajisjes sipas procesverbaleve të dorëzimit të saj;
7. Të interpretojë rëndësinë e ruajtjes së dokumentimit teknik dhe ligjor sipas rregullores së brendshme;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të shqyrtojë dokumentacioni teknik dhe ligjor të nevojshëm;
2. Të plotësojë/gjenerojë procesverbale/raporte gjatë proceseve të punës;

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin e fushës në fuqi sipas standardeve përkatëse;
- Përdor me korrektësi dokumentacionin teknik, sipas qëllimit të përdorimit;
- Plotëson procesverbalin e instalimit dhe të konfigurimit të pajisjes elektronike, sipas formateve;
- Plotëson raportet e shërbimeve sipas grafikut të mirëmbajtjes dhe formateve;
- Plotëson saktë dokumentin për kushtet e garancisë së pajisjes elektronike;
- Përpilon aktin e dorëzimit të pajisjes elektronike sipas procesverbaleve të dorëzimit të

- saj;
- Plotëson dhe ruan dokumentacionin teknik dhe ligjor sipas standardit dhe rregullores së brendshme;

E6-32-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi për sipërmarrjen;
2. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të dokumentacionit menaxhues dhe tregtar dhe mënyrat e ruajtjes së tyre;
3. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së planeve të punës për të arritur objektivat e biznesit;
4. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e hartimit të një urdhri pune duke specifikuar detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet e punës;
5. Të shpjegojë mënyrën e hartimit dhe monitorimit të inventarit të mjeteve dhe materialeve;
6. Të shpjegojë rëndësinë e informacionit nga burime të ndryshme për çmimet dhe cilësinë e mjeteve dhe materialeve të punës për të optimizuar performancën dhe efikasitetin e veprimtarisë;
7. Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së kostos dhe kohës së punës për mjete dhe materiale;
8. Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së një oferte duke përdorur strategjitë e marketingut;
9. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së kostos dhe çmimit të një shërbimi;
10. Të shpjegojë mënyrën e plotësimit/gjenerimit të faturave;
11. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknikave të marketingut për të rritur shitjet e kompanisë;
12. Të përshkruajë llojet e raportimeve financiare dhe mënyrën e përgatitjes së tyre;
13. Të përshkruajë rëndësinë e hartimit të inventarit lidhur me konsumin e materialeve gjatë procesit të punës;
14. Të shpjegojë rëndësinë e vetëvlerësimit për të përmirësuar ndërveprimin dhe performancën në ambientet e punës;
15. Të përshkruajë strategjitë dhe teknikat e zhvillimit të vazhduar profesional;
16. Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit me aplikimin e teknologjive dhe metodave të reja nëpërmjet panairëve, ekspozitave, literaturave etj. si dhe transmetimin në kohë të njohurive tek bashkëpunëtorët;

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë procedurat për kryerjen e detyrave administrative dhe tregtare;
2. Të zbatojë teknikat e marketingut;
3. Të kryejë trajnime të vazhduara bashkëkohore;

Kriteret e vlerësimit

- Plotëson dokumentacionin menaxhues dhe tregtar sipas formateve;
- Harton dhe ruan dokumentacionin menaxhues dhe tregtar sipas rregullores së brendshme të kompanisë;
- Përgatit plane pune sipas formateve për të arritur objektivat e biznesit;

- Specifikon detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet e punës për të siguruar që operacionet të jenë të qarta dhe efikase.
- Zbaton parimet dhe legjislacionin në fuqi për të mbrojtur të drejtat dhe detyrat e punonjësve dhe punëdhënësve;
- Kryen inventarin e mjeteve dhe materialeve për të menaxhuar efikasitetin dhe burimet e disponueshme të kompanisë, sipas nevojës;
- Siguron informacion të përditësuar dhe të saktë për çmimet dhe cilësinë e mjeteve dhe materialeve për të optimizuar performancën dhe efikasitetin e operacioneve;
- Llogarit koston dhe kohën e punës së mjeteve dhe materialeve sipas operacioneve që do të kryhen;
- Përgatit oferta për të identifikuar nevojat e klientit, për të llogaritur kostot dhe çmimet si dhe për të siguruar që ofertat janë të konkurrueshme në treg;
- Llogarit kostot dhe çmimin përfundimtar të shërbimeve, sipas rregullit.
- Përgatit/gjeneron faturat sipas rregullit;
- Aplikon strategjitë e marketingut për të rritur ndërgjegjësimin e markës, për të rritur shitjet dhe për të mbajtur marrëdhëniet me klientët, sipas teknikave të marketingut.
- Përgatit raportet operative, financiare dhe analitike për të monitoruar performancën si dhe për të marrë vendime strategjike, sipas formateve përkatëse.
- Përgatit inventare, sipas formatit;
- Vlerëson aftësitë vetjake për të përmirësuar ndërveprimin dhe performancën sipas nevojës
- Përdor strategji dhe teknika për të rritur aftësitë në karrierë, duke përfshirë trajnime etj. sipas nevojës;
- Planifikon hapa për t'u zhvilluar në karrierë, sipas nevojës dhe proceseve të punës;
- Përdor teknologjitë bashkëkohore dhe mjete të reja për të përmirësuar efikasitetin dhe performancën në proceset e punës;
- Përdor teknika të ndryshme bashkëpunimi për të ndarë njohuri dhe për të zbatuar inovacione në projekte dhe detyra të ekipit, sipas nevojës së proceseve të punës.
- Merr pjesë rregullisht në panairë dhe ekspozita si platforma për të promovuar produkte, shërbime dhe inovacione;
- Studion literaturën bashkëkohore për fushën sipas nevojës dhe rastit, për të rritur njohuritë dhe aftësitë;
- Kryen trajnime dhe kurse që ofrohen për të përmirësuar aftësitë dhe njohuritë, sipas nevojës.

E6-31-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të Kodit të etikës;
2. Të përshkruajë parimet e punës në grup;
3. Të përshkruajë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
4. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
5. Të përshkruajë teknikat dhe metodat e zgjidhjes së konflikteve;
6. Të përshkruajë rëndësinë e mendimit kritik;

7. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit etik me kolegët, eprorët, klientët, bashkëpunëtorët etj.;
8. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK në komunikim me të tjerët;
9. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë Kodin e Etikës në komunikim sipas hierarkisë;
2. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
3. Të përdorë terminologji profesionale gjatë komunikimit;

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton Kodin e Etikës;
- Komunikon në mënyrë verbale dhe jo verbale sipas rregullit;
- Zbaton saktë parimet e punës në grup;
- Përdor terminologji të qartë dhe profesionale sipas fjalorit teknik të fushës;
- Përzgjedh teknikat dhe metodat e komunikimit për zgjidhjen e konflikteve;
- Zbaton saktë rregullat e komunikimit etik dhe profesional me kolegët, eprorët, klientët, bashkëpunëtorët etj.;
- Përdor në mënyrë profesionale teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit;
- Zbaton teknikat e motivimit për të arritur një komunikim të mirë me të tjerët.
- Zbaton saktë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera gjatë ndërveprimit/komunikimit me të tjerët.

E6-05-IV-0171-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar në fuqi për rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtje së mjedisit;
2. Të shpjegojë masat për mbrojtjen nga rryma elektrike, mbrojtjen nga shoku elektrik, mbrojtjen nga efektet termike, mbirrymat etj.;
3. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të manualeve të makinerive dhe pajisjeve të punës;
4. Të përshkruajë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
5. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të sinjalistikës në mjediset e punës;
6. Të përshkruajë procedurat e evakuimit në raste emergjente;
7. Të përshkruajë procedurat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti dhe përdorimin e mjeteve përkatëse;
8. Të shpjegojë rëndësinë e identifikimit dhe raportimit tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurimit teknik;
9. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të veshjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive;
10. Të përshkruajë rregullat e trajtimit, klasifikimit dhe grumbullimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme si bateri, kondensatorë dhe elementë të tjerë elektronikë në përputhje me legjislacionin në Republikën e Shqipërisë;
11. Të përshkruajë rregullat përkatëse gjatë përdorimit të solucionave me përmbajtje kimike;

12. Të përshkruajë rëndësinë e ndarjes së mbetjeve sipas llojit dhe depozitimin e mbetjeve toksike në vendin e duhur;
13. Të përshkruajë kushtet teknike të ruajtjes dhe magazinimit të materialeve në mënyrë që mos rrezikojë ndotjen e mjedisit;
14. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit në mënyrë racionale të energjisë, ujit dhe materialeve në zbatim të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm;
15. Të përshkruajë protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës;
2. Të koordinojë masat për të minimizuar rrezikun e aksidenteve në vendin e punës.
3. Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
4. Të zbatojë politika dhe strategji për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e burimeve të qëndrueshme.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton masat për mbrojtjen nga rryma elektrike, shoku elektrik, efektet termike, mbirrymat etj.;
- Përdor manualët e makinerive dhe pajisjeve të punës sipas kërkesave;
- Përdor pajisjet e mbrojtjes nga zjarri, kontaktit me energjinë elektrike dhe shpëtimit sipas rregullores;
- Respekton sinjalistikën në mjediset e punës;
- Zbaton procedurat e evakuimit për raste emergjence, sipas protokolleve;
- Zbaton procedurat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti dhe përdorimin e mjeteve përkatëse me korrektësi;
- Raporton rregullisht tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurimit teknik;
- Përdor veshjet mbrojtëse individuale dhe kolektive, në zbatim të kushteve teknike;
- Zbaton rregullat e trajtimit, klasifikimit dhe grumbullimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme si bateri, kondensatorë dhe elementë të tjerë elektronikë në përputhje me legjisllacionin në fuqi;
- Zbaton rregullat e ndarjes së mbetjeve sipas llojit dhe depozitimin e mbetjeve toksike në vendin e duhur;
- Zbaton rregullat përkatëse gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
- Identifikon kushtet teknike të ruajtjes dhe magazinimit të materialeve në mënyrë që mos rrezikojë ndotjen e mjedisit;
- Përdor në mënyrë racionale energjinë, ujin dhe materialet në zbatim të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Ndjek trajnime periodike për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në riparime të pajisjeve elektronike	10	E6-05-IV-0186-24
2	Instalimi i pajisjeve elektronike dhe lidhja e tyre në rrjet	25	E6-05-IV-0187-24
3	Diagnostikimi, riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektronike	25	E6-05-IV-0188-24
4	Dokumentacioni teknik dhe ligjor	10	E6-05-IV-0189-24
5	Sipërmarrje dhe edukim karriere	10	E6-32-IV-0005-24
6	Komunikimi dhe etika profesionale	10	E6-31-IV-0006-24
7	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit	10	E6-05-IV-0171-24
Totali		100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikimi i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;

- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- d) njohjes të të nxënës të mëparshëm informal dhe joformal;
- e) njohjes të të nxënës të përfutur jashtë vendit;
- f) formave të tjera të përcaktuara me ligj

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **K-E6-IV-24**

K - Kualifikim

E - Shkronja që identifikon drejtimin e kualifikimit

6 - Numri që identifikon profilin e kualifikimit përkatës

IV - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënës: **E6-05-IV-0186-24**

E6 - Shkronja që identifikon drejtimin dhe profilin e kualifikimit

05 - Numri që identifikon orientimin e Njësisë së të Nxënës

IV - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënës në strukturën e KSHK

0186 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënës në ditën e hartimit përkatës

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënës